



GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Enes Mehmeti, me bashkëpunëtorin profesional Fatlum Halimi, në çështjen juridike të paditësit [REDACTED], dega në [REDACTED], Rr. "[REDACTED]" [REDACTED], kundër të paditurve: [REDACTED] dhe [REDACTED], që të dy nga fshati [REDACTED], Rr." [REDACTED] [REDACTED]" p.n. Komuna [REDACTED], për shkak të kthimit të borgjit nga kontrata mbi huanë, jashtë shqyrtimit kryesor, me datë 29.09.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- për shkak të padëgjueshmërisë / mosbindjes -


I- APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit [REDACTED], dega në [REDACTED] si e bazuar.

II- DETYROHEN të paditurit: [REDACTED] dhe [REDACTED], të dy nga Fshati [REDACTED] Komuna [REDACTED], që paditësit në mënyrë solidare t'ia kthejnë borgjin në shumë prej **3,710.40 €** (tremijë e shtatëqind e dhjetë euro e 40 cent) me kamatë ligjore nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

III- OBLIGOHET paditesi të paguaj taksën gjyqesore në shumë prej prej 40€, menjherë pas pranimit të kopjes së tij, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Paditësi, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurve, për pagimin e borgjit, të krijuar me kontratë mbi huanë. Si provë, paditësi ka sjellur Marrëveshjen për kredinë NR. KOFE-0012540-001 të datës 30.06.2016 të lidhur në mes të paditësit si kredidhënës dhe të paditurve si kredimarrës; fletë-transaksionin (Report Nr.L01) që përfshinë periudhën 30.06.2016 deri 28.04.2017, e printuar me datë 26.07.2017 në emër të të paditurit të parë [REDACTED];



shtojcën nr.1 e datës 30.06.2016 me të cilën parashihet orari i kthimit të kredisë; vërejtjen me shkrim të datës 05.12.2016 të cilën paditësja ia ka drejtuar të paditurve për pagimin e borgjit.

Gjykata, të paditurve, me datë 18.08.2017, u'a ka dorëzuar padinë së bashku me provat e lëndës si dhe aktvendimin për përgjigje në padinë e paditësit, por të paditurit, ndonëse i kanë pranuar shkresat me rregull (provë: fletëkthesa e nënshkruar nga të paditurit me datë 18.08.2017) brenda afatit të caktuar ligjor, me aktvendimin për dhënien e përgjigjes në padi, nuk kanë ushtruar në këtë gjykatë përgjigjen e tyre nëse e kundërshtojnë apo jo kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa gjykata nga provat e çështjes, ka gjetur se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet e tilla nuk janë në kundërshtim me provat e propozuara nga paditësi, si dhe duke pasur parasysh faktin se të paditurit kanë pranuar me rregull padinë me prova dhe aktvendimin për përgjigje në padi (personalisht), gjykata bazuar në nenin 150.6 të LPK-së, ka vendosur që të marrë aktgjykim kontumacional, pa dëgjimin e palëve ndërgjygjëse.


Gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë nga neni 150.2 të LPK-së, që përjashton mundësinë për nxjerrjen e aktgjykimit të tillë, në rastin konkret.

Gjykata lidhur me kamatën ka vendosur në bazë të nenit 378 të LMD-së, duke qenë se për paditësin, lartësia e borxhit ka qenë e përcaktuar që në kohën e ngritjes së padisë.

Gjykata ka obliguar të paditurit për kompensimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore në bazë të nenit 452.1 të LPK-së, ndërsa paditësin në bazë të UA nr.01/2017 të KGJK-se, për unifikimin e taksave gjyqesore.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.606/17, me datë 29.09.2017

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ II UROŠEVAC

Më 01-12 2017
Dana

Gjyqtari,
Enes Mehmeti




KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të tij, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

